

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues Sahit Krasniqi dhe me zyrtaren ligjore Gentiana Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit L.B. nga Kaçaniku, për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit në vazhdim nga neni 424 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I. nr. 32/20 të dt. 06.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit publik për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani, të pandehurit L.B., dhe mbrojtësit të tij av. Nikë Shala, me datë 27 korrik 2020 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 03 shtator 2020 perpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **L.B.**, i lindur me dt.në Shkup, nga i ati dhe e ëma, e vajzërisë, me vendbanim në Kaçanik, “..... ”, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme-hotelierit, pronar i kafiterisë “.....” me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, baba i një fëmije, me numër letërnjoftimi

ËSHTË FAJTOR

- 1. Sepse:** Gjatë vitit 2017 në Kaçanik, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka dhënë para në shumë prej 2000 euro të pandehurit A.M. në mënyrë që të ushtroj ndikim të pa drejt në vendimmarrjen e personave zyrtar, në atë mënyrë që janë takuar në kafiterinë e tij në Kaçanik, me ç ‘rast i pandehuri L..... është interesuar që ta punësoj bashkëshorten e tij, kurse i pandehuri i ka premtuar se do ta regjistrojë në Departamentin e Gjendjes Civile në Kaçanik duke i kërkuar 2000 euro si hua, mirëpo nuk ka arritur që të ushtroj ndikim për të punësuar bashkëshorten e tij e gjithashtu nuk ia ka kthyer paratë.

2. Sepse: Gjatë vitit 2018, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka dhënë 1500 € të pandehurit A.M. që të ushtroj ndikim të padrejtë në vendimmarrjen e personit zyrtar, hetuesi L.M., në atë mënyrë që pas takimit paraprak në kafiterinë e tij në Kaçanik ku kanë biseduar për rastin që është në hetim paraprak nga hetuesit e DHKEK-ës në Prishtinë me numër të rastit DHKEK-P-165/18, në të cilën familja e të pandehurit ka pasur interesa pasurore, kështu që pas disa dite janë takuar në një restorant në magjistralen Ferizaj – Prishtinë ku ja ka dhënë paratë, kurse me datë 21 Janar 2020 ka shkuar në zyrën e të pandehurit A..... dhe e ka njoftuar se është intervistuar nga hetuesit e DHKEK-ës në mesin e të cilëve edhe L.M., dhe kërkon që të takohen në një lokal në regjionin e Ferizajt për të biseduar lidhur me mbylljen e rastit.

- me të cilën ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit në vazhdim nga neni 424 par. 2 të KPK-së.

Andaj në bazë të dispozitave të nenit 366 par. 1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 42, 43, 69, të KPRK-ës dhe neneve 233 dhe 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

ME DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ muajve, në të cilin do të llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 06 shkurt 2020 deri me date 02 korrik 2020 dhe koha e kaluar ne arrestin shtëpiak nga data 02 korrik 2020 deri me date 27 korrik 2020.

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 1500 / një mijë e pesëqind /€, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20€ do të vuaj nga një ditë burgimi.

I pandehuri, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumen prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe të paguaj shumen prej 50/pesëdhjetë/euro në Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar si PP/I. nr. 32/20 të dt. 06.07.2020, ka akuzuar të pandehurin L.B. nga Kaçaniku rr'' , për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit në vazhdim nga neni 424 par. 2 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit aktakuzës së paraqitur i ka bashkangjitur edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë të dt. 01.07.2020, deklaratën e të pandehurit të të njëjtës datë, e nënshkruar nga ana e të pandehurit L.B., mbrojtësi i tij av. Nikë Shala, prokurori i shtetit Sebahate Sinani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Shukri Jashari.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes me datë 27.07.2020, në të cilën i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkritazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë, duke i propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara.

2. Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 233 par. 18 të KPP-ës:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësi e tij av. Nikë Shala,
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë nga mbrojtja e të pandehurit dhënë gjatë procedurës

hetimore, raporti i oficerit si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të siguruar gjatë procedurës hetimore;

- si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj, gjykata pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

3. Vlerësimi ligjor

Duke vlerësuar në aspektin juridik Gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit L.B. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale ushtrimi i ndikimit në vazhdim nga neni 424 par. 2 të KPRK-së, siç është përshkruar hollësisht në dispozitivat e këtij aktgjykimi.

4. Vlerësimi për dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata vlerësoj se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe përmes dënimit të shqiptuar me burgim prej 5/pesë/ muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1500 /njëmijë e pesëqind/ euro, do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe të paguaj shumën prej 50/pesëdhjetë/euro në Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, PKR.nr. 98/20 me 03.09.2020**

**Zyrtare ligjore,
Gentiana Hoxha**

**Kryetari i trupit gjykues,
Sahit Krasniqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.